



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI"-PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI"-PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI"-PRIŠTINA

Njësia Org.	1.H.	Nr. l.prot.	
Org. Unit		Prot.N.	01/68/2026
Org.Jed.		Br.Prot.	
Nr.i.Faqeve		Date:	
No. Pages	4/9	Datum:	07.04.2026
Br. Stranica			

PRISHTINË - A



Mbështetur në paragrafin 5 të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nën paragrafi 1.1. i nenit 18 të Statutit nr. 01B-195 dt. 31.10.2024, të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë "Ali Hadri", në mbledhjen e datës 07. 04. 2026, miratoi:

## REGULLORE PËR HONORARËT E AUTORËVE PËR VEPRIMTARINË BOTUESE NË INSTITUTIN E HISTORISË "ALI HADRI"

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë standardet, kriteret dhe mënyrën e kompensimit, përfshirë lartësinë e honorarëve, për autorët dhe bashkëpunëtorët e angazhuar në veprimtarinë botuese dhe aktivitetet kërkimore-shkencore të Institutit të Historisë, përfshirë kryeredaktorët, redaktorët shkencorë, recensentët, përkthyesit dhe kontribuesit e tjerë shkencorë, në harmoni me standardet profesionale dhe aktet në fuqi të Institutit.

#### Neni 2

##### Pagesa për botimet shkencore

1. Për botimet shkencore autorët paguhen:
  - 1.1. Për autorësinë e monografisë shkencore – 150 € për një tabak autori;
  - 1.2. Për autorësinë e përmbledhjes me dokumente – 100 € për një tabak autori;
  - 1.3. Për autorësinë e përmbledhjes me punime dhe materiale të tjera individuale – 80 €;
  - 1.4. Për autorësinë e përmbledhjeve të kumtesave të konferencave, tryezave shkencore dhe aktiviteteve të tjera shkencore – 150 € për punim.
  - 1.5. Për çdo ribotim të veprës honorari i autorit zvogëlohet për 40%.
2. Pagesa sipas këtij neni realizohet vetëm pas dorëzimit të produktit shkencor botimit dhe verifikimit nga organet përgjegjëse të Institutit.

### Neni 3

#### Pagesa për botime dhe aktivitete shkencore

1. Për angazhime në botime dhe aktivitete shkencore, pagesa parashihet si në vijim:
  - 1.1. Kryeredaktori – 20 € për një tabak autori;
  - 1.2. Redaktori shkencor – 17 € për një tabak autori;
  - 1.3. Botuesi (për botimin) – 10 € për një tabak autori;
  - 1.4. Recensenti për botime monografike – 10 € për një tabak autori;
  - 1.5. Recensenti për botime me dokumente – 8 € për një tabak autori;
  - 1.6. Autori i botimeve biografike – 60 € për një tabak autori;
  - 1.7. Autori i leksikoneve – 60 € për një tabak autori;
  - 1.8. Autori i botimeve enciklopedike – 60 € për një tabak autori;
  - 1.9. Pagesa e autorit të monografisë redaktorialë-200 € për tabak autori;
  - 1.10. Redaktuesi gjuhësor për të angazhuar – 10 € për një tabak autori;
  - 1.11. Anëtari i këshillit organizues të konferencave dhe aktiviteteve shkencore – 100 €;
  - 1.12. Moderatori i aktiviteteve të Institutit – 100 €;
  - 1.13. Sekretari i redaksisë – 10 € për një tabak autori;
  - 1.14. Përgatitja teknike për botim – 10 € për një tabak autori.
2. Për angazhimet në revistën shkencore “KOSOVA” (në gjuhën shqipe), kompensimi është si në vijim:
  - 2.1. Anëtari i redaksisë – 150 € për numrin;
  - 2.2. Kryeredaktori – 25 € për një tabak autori;
  - 2.3. Sekretari i redaksisë – 15 € për një tabak autori;
  - 2.4. Redaktuesi gjuhësor për të angazhuar – 10 € për një tabak autori;
  - 2.5. Përgatitja teknike për botim – 10 € për një tabak autori.
3. Për angazhimet në revistën shkencore “KOSOVA: Historical/Political Review” (në gjuhën angleze), kompensimi është si më poshtë:
  - 3.1. Autori i artikullit shkencor – 200 € për punim;
  - 3.2. Për punime me rendësi të veçantë për autorët ndërkombëtarë – 250 € për punim;
  - 3.3. Autori i materialeve, dokumenteve etj. – 70 € për punim;
  - 3.4. Recensionet – 50 € për recension;
  - 3.5. Anëtari i redaksisë – 150 € për numrin;
  - 3.6. Kryeredaktori – 25 € për një tabak autori;
  - 3.7. Sekretari i redaksisë – 15 € për një tabak autori;
  - 3.8. Recensenti ndërkombëtar për revista dhe periodik-200 € për numrin;
  - 3.9. Redaktuesi gjuhësor për të angazhuar – 10 € për një tabak autori;
  - 3.10. Përgatitja teknike për botim – 10 € për një tabak autori.

4. Për qëllime financiare, zyra e financave e Institutit përpilon faturën e shpenzimit për botimin ose angazhimin përkatës, lidhur me pagesën e honorarit për autorësinë dhe angazhimet e tjera në kuadër të veprimtarisë botuese dhe shkencore, të cilën e nënshkruajnë drejtori/ja dhe përfituesi i honorarit. Palëve u takon nga një kopje e këtij dokumenti. Ky dokument ka fuqi ekzekutive.
5. Pagesa realizohet vetëm pas përfundimit të detyrës përkatëse, dorëzimit të produktit shkencor, botimit dhe verifikimit nga organet përgjegjëse të Institutit, në harmoni me procedurat përkatëse dhe aktet në fuqi.

#### **Neni 4**

##### **Përkthimet**

1. Të angazhuarit për përkthimin e monografive shkencore dhe Akteve nga aktivitetet shkencore në kuadër të veprimtarisë botuese të Institutit kanë të drejtë në kompensim financiar, i cili caktohet në bazë të gjuhës së përkthimit dhe formës së tekstit.
2. Për përkthimin e monografive shkencore dhe Akteve nga aktivitetet shkencore, pagesa për një faqe përcaktohet si vijon:
  - 2.1. Përkthimi nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas – 15 €;
  - 2.2. Transkriptimi dhe përkthimi i teksteve në gjuhët e vjetra (latinisht, greqisht, sllavisht, osmanisht etj.) – 30 €.
3. Pagesa për përkthimin realizohet vetëm pas dorëzimit të plotë të materialit të përkthyer, pas botimit dhe verifikimit nga organet përkatëse të Institutit, në pajtim me standardet dhe aktet në fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Kompensimi për dorëzimin e dokumenteve arkivore**

1. Materialet arkivore apo burimore të veçanta që dorëzohen në Arkivin e Institutit nga persona fizikë jashtë Institutit, kompensohen me shumën prej 10 € për një tabak autori.
2. Vlerësimin e materialeve arkivore e kryen një komision i përbërë prej tre (3) anëtarësh, të emëruar me vendim të drejtorit të Institutit.
3. Anëtarët e komisionit të vlerësimit kompensohen me nga 100 € për çdo rast të vlerësuar, në mënyrë individuale.

## Neni 6

### Angazhimi në projekte shkencore

1. Studiuesve të brendshëm të Institutit, të angazhuar në projekte shkencore brenda territorit të Republikës së Kosovës, në distancë më të madhe se 40 kilometra nga qendra e Institutit, u takon kompensimi në shumën prej 20 € për ditë pune.
2. Studiuesve të brendshëm dhe të jashtëm, të angazhuar në projekte shkencore brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, u mbulohen shpenzimet e akomodimit, hulumtimit dhe mëditjet, në përputhje me rregulloren për udhëtime zyrtare dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

## Neni 7

### Dispozitat kalimtare

1. Procedurat për realizimin e kompensimeve sipas kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha angazhimet dhe veprimtaritë shkencore të filluara pas hyrjes në fuqi të saj.
2. Angazhimet dhe veprimtaritë shkencore të realizuara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, për të cilat ekziston obligim kompensimi nga Instituti dhe që nuk janë përmbyllur financiarisht, do të kompensohen në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## Neni 8

### Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e mëhershme Nr.01/99/25, e datës: 30.05.2025,

## Neni 9

### Dispozitat përfundimtare

1. Zbatimin e kësaj Rregulloreje e siguron Drejtori i Institutit, në bashkëpunim me Sekretarin e Institutit dhe Këshillin Drejtues.
2. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet me propozim të Këshilli Drejtues, Drejtorit apo të Këshillit Shkencor.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues dhe publikohet në uebfaqen zyrtare të Institutit.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. dr. Teuta Shala-Peli

